



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.24.07.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Përf. e KFOR-it dhe drejtorët komunal

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2025
4. Raporti i Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2024
5. Shqyrtimi i kërkesës nga DPUKP-ja, nr.05-070/05-0006650/25, të dt.02.07.2025
6. Shqyrtimi i kërkesës nga DSHMS-ja, nr.08-104/02-18721/25, e dt.10.07.2025
7. Shqyrtimi i kërkesave
8. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 7 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2025.

Enver Gashi – Së pari raporti është me kohë dhe ne jemi për atë që ky raport të shkoj në Kuvend dhe në Kuvend nëse, dikush ka diçka mund ta jepë kontributin e vetë.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që ta dërgojmë në seancën e Kuvendit Komunal këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa kërkojmë që personat përgjegjës të jenë atje në ditën e mbajtjes së seancës, në mënyrë që nëse kemi ndonjë pyetje ose paqartësi ta sqarojmë në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e shpenzimeve për periudhën Janar – Qershor 2025.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2024.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë të rendit të ditës jemi për atë që të shkoj në Kuvendin Komunal dhe atje mund ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Është rregullë dhe obligim që çdo vit ta shqyrtojmë këtë pikë të rendit të ditës, kështu që ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e Auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2024.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DPUKP-ja, nr.05-070/05-0006650/25, të dt.02.07.2025.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi dakord që të kaloj në Kuvend.

Sami Ahmeti – Natyrisht ne e kemi bërë një Komision, ky Kuvend që merret me këtë çështje dhe na është ardhë një kërkesë që ishte bërë në mars sa e pashë unë kërkesën, ka ardhë afër 4 muaj më vonë. Sido që të jetë ne jemi për atë që të shkoj si pikë e rendit të ditës në Kuvend, ndërsa a është në rregullë apo nuk është do të bisedojmë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DPUKP-ja, nr.05-070/05-0006650/25, të dt.02.07.2025.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti shqyrtimin e kërkesës nga DSHMS-ja, nr.08-104/02-18721/25, e dt.10.07.2025.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi dakord që të shkoj në Kuvend, por të jenë prezentë zyrtarët e shëndetësisë dhe të na sqarojnë mirë se a është punë e jona, apo e Drejtorisë drejtëpërsëdrejti, pastaj marrim vendim.

Sami Ahmeti – Ne jemi për që policisë të iu mundësohet papagesë çka kanë kërkuar sepse nuk po e dijme çka kanë kërkuar, por jemi kundër që kjo pikë të shkoj në seancë sepse kështu dhe ashtu Ministria e administrimit të pushtetit lokal ka me kthye prapa. Pra, pa material me kohë sikurse që iu kanë referue edhe më herët 7 ditë para kohe nuk shkon asnjë vendim, aq më tepër ku ka implikime financiare nuk ka mundësi me u marrë si i mirëqenë dhe nuk aprovohet si vendim. Unë propozoj që ta shtyejmë për muajin e ardhshëm sepse si i tillë është vetëm si vendim kot.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nga DSHMS-ja, nr.08-104/02-18721/25, e dt.10.07.2025.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – E kemi një kërkesë nga Zyra për barazi gjinore për dhënien në debat publik të Planit të vpeirmit për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Obiliqit 2026-2029 dhe Strategjinë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Këtë kërkesë ne do të ia rekomandojmë Kuvendit Komunal si pikë e 7 e rendit të ditës.

Enver Gashi – Ne si grup jemi që kjo pikë të shkoj si pikë e 7 e rendit të ditës dhe aty në mënyrë detale do ta shqyrtojmë.

Sami Ahmeti – Përsëri në parim nuk jemi kundër që kjo të shkoj në debat publik, por përsëri pa mbështetje pa dokumente, pa kërkesë, pa pasë ne asgjë në dispozicion më duket se nuk është në rregullë dhe përsëri kthehet prapa. Unë e di se shkuarja në debat publik nuk ka ndonjë problem dhe gjithsesi ne nuk jemi kundër, por në parim po i bëjmë disa gabime të tilla që nuk ka nevojë ti bëjmë.

Kryesuesja – Ju njoftoj paraprakisht se debati publik nuk i nënshtrohet ligjshmërisë së Ministrisë, por ka ardhë një ditë pasi që ka shkue materiali në Komitet dhe OSBE-ja, në takim ka thënë se është e domosdoshme të përfshihet në Kuvend për shkak të personave me aftësi të kufizuara, sa më parë të dalë në debat publik që të aprovohet deri në fundvit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal si pikë të 7 të rendit të ditës dhënien në debat publik të Planit të vepimit për persona me aftësi të kufizuara në Komunën e Obiliqit 2026-2029 dhe Strategjinë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Kryesuesja – Ju njoftoj se ka ardhë një kërkesë nga MAPI-ja, për shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 99 vite investitorëve “A Marketing dhe Roto Recycling” .

Enver Gashi – Ne vendimet e Ministrisë nuk mundemi me i ndryshue dhe jemi për atë që ti rekomandojmë Kuvendit Komunal

Sami Ahmeti – Jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shfuqizimin e vendimit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës për 99 vite investitorëve “A Marketing dhe Roto Recycling” .

Kryesuesja – Ju keni pranuar një kërkesë nga Mentor Ramadani për mosinimin e procedurës për shfuqizimin e vendimit nr.01-060-01-13275-25, të dt.16.05.2025.

Enver Gashi – Unë sa jam në dijeni ky është kërcënue se do të bëjë padi në Gjykatë, por ne i referohemi në plotëni ligjeve të pushtetit lokal dhe jemi për atë që kjo të shkon në Kuvend.

Sami Ahmeti - Nëse, kërkojmë dhe iu themi të dyjave po do të thotë se jemi kontradiktor. E para është për me shfuqizue me respektue ligjin, me i respektue institucionet ndërsa e dyta është normale që subjekti ose operatori ekonomik kërkon mos të bëhet kjo sepse e din se të paktën për 5,6 muaj shtyhet rivendosja. Megjithatë, mua nuk më duket e arsyeshme me dërgue diçka që e dijmë saktë se nuk përshkon me ligjin, kështu që ne jemi kundër.

Kryesuesja – Ne mundemi me dërgue në Kuvend kërkesën me njoftue Kuvendin, por nëse nuk e shfuqizojmë vendimin e shkelim ligjin sepse MAPL-ja, me kohë e ka njoftue Kryetarin dhe Kryesuesen e Kuvendit.

Anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa, me 5 vota për dhe 2 vota kundër ia rekomanduan Kuvendit Komunal kërkesë dhe me njoftue Kuvendin, vendimin nga Mentor Ramadani.

Pika 8 e rendit të ditës

Labiniot Mirena – Unë e kam një kërkesë prej një bashkëfshatarit tim z.Jeton Mirena, që jeton në lagjen Hade e Re-Shkabaj. Ai e ka bërë një kërkesë me dt.18.04.2025 ia ka drejtue Komunës dhe policisë sepse në orët e vona në fshat po ka thyerje, tentim thyerje dhe kërkesa është për vendosjen e kamerave publike, aty ku nuk funksionon ndriçimi me shkue dhe me bë aktive. Pra, gjatë orëve të vona të natës po ka telashe prej x personave që janë duke e shqetësue atë lagje andej. Unë kërkesën e kam këtu, dhe ia adresoj kryesueses, dhe besoj se kur diskutohet diçka në KPF është mirë të merret parasysh edhe kjo kërkesë e qytetarëve të fshatit Shkabaj.

Kryesuesja – Ne mund ti rekomandojmë Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi që me trajtue këtë kërkesë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:22’

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

